ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-25-3344-2-2-1**

Sa i përket tenderit për: Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për ndërtim,rinovim dhe legalizim sipas nevojave të DPMS-s

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

STUDIO HAPSIRA SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Mat - Prishtinë
(Adresa)

Prishtinë
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

045 150 123
Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Edmond Halimi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

infostudiohdesign@gmail.com
(Adresa elektronike)

03.07.2025
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Avokat Qëndrim Arifi
(Emri i avokatit)

Rr. "Idriz Gjilani", Llamela 15, Kati 2, Nr. 213, Dardani, Prishtinë.
(Adresa e plotë)

+383 49 875 852 ***N/A***
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

qendrim1.arifi@gmail.com
(Adresa elektronike)

03.07.2025
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë:12.05.2025
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 23.05.2025
Njoftim mbi Vendimin e AK-së: 16.06.2025
Kërkesë për Rishqyrtim 20.06.2025;
Vendimi lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim: 23.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 10 i RrPP-së
Neni 43 i RrPP-së
Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne si Grup i Operatorëve Ekonomik STUDIO HAPSIRA SH.P.K.; FST Engineering SH.P.K dhe GJEO-PROJEKT SH.P.K. (tutje e gjeni si STUDIO HAPSIRA SH.P.K.) më datë 23.05.2025 kemi dorëzuar ofertën tonë për aktivitetin e prokurimit: **"Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për ndërtim,rinovim dhe legalizim sipas nevojave të DPMS-s",** ndërsa më datë 16.06.2025, Autoriteti Kontraktues ka bërë publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, me të cilin ka anuluar në tërësi aktivitetin e prokurimit.

AK e ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyen se kinse: ***"Në paramasën e publikuar nga AK-ja ka pozicione të cilat nuk janë të arsyeshme si në:***

- ***Pozicionin A pika 2,3,4, dhe 5,***
- ***Pozicioni B pika 3, dhe 7***
- ***Pozicioni E, pozicioni F,***
- ***Pozicioni G dhe***
- ***Pozicioni H pika 2.***

Pra, ky është i tërë arsyetimi i AK-së për OE-të pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit pa dhënë ASNJË arsye tjetër, duke e bërë këtë vendim përveç të kundërligjshëm, në të njëjtën kohë edhe tejet arbitrar.

STUDIO HAPSIRA SH.P.K., më 20.06.2025 pranë AK-së ka parashtruar Kërkesës për Rishqyrtim, ndërsa AK më 16.06.2025 nxjerr Vendim me të cilin REFUZON në tërësi Kërkesën për Rishqyrtim, gjithashtu pa dhënë asnjë ARSYE shtesë për pretendimet tona të ngritura me Kërkesën për Rishqyrtim.

PROVË: Kërkesa për Rishqyrtim dhe Vendimi për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim i publikuar më 16.06.2025.

STUDIO HAPSIRA SH.P.K nuk është e kënaqur me Vendimin lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim, për faktin e i njëjti nuk është përpiluar konformë kërkesave ligjore dhe nuk i përgjigjet pretendimeve ankimore të parashtruara nga ne, konkretisht:

PRETENDIMET ANKIMORE

<u>Pretendimi 1:</u> Vendimi për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim nuk i trajton pretendimet ankimore të ngritura nga STUDIO HAPSIRA SH.P.K.

AK nëpërmjet Vendimit të datës 16.06.2025 për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim NUK I TRAJTON fare pretendimet ankimore të ngritura nga STUDIO HAPSIRA SH.P.K. Konkretisht në vend që AK tu përgjigjej pretendimeve tona ankimore lidhur me atë se anulimi i aktivitetit të prokurimit është në kundërshtim me dispozitat ligjore, e njëjta vetëm përsëritë se: *"Komisioni i përbërë nga dy ekspert të fushës dhe një zyrtar i prokurimit publik, ka konstatuar se në dosje të tenderit në paramasë janë përfshir pozicione të cilat nuk janë të nevojshme dhe të cilat ndikojn në implementim të projektit, pozicionet të cilat nuk janë të nevojshme:*

- *Pozicionin A pika 2,3,4, dhe 5,*
- *Pozicioni B pika 3, dhe 7*
- *Pozicioni E, pozicioni F,*
- *Pozicioni G dhe*
- *Pozicioni H pika 2."*

Vendimi i AK-së i pa arsyetuar, respektivisht pa i trajtuar pretendimet ankimore të STUDIO HAPSIRA SH.P.K, shkelë në mënyrë flagrante **Nenin 62, par. 2 të RrPP-së**, i cili nen kërkon taksativisht se: *"**Vendimi mbi refuzimin do të arsyetohet** dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit".* Përveç kësaj, Vendimi i AK-së bije ndesh edhe me **Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ**e, ku në **nenin 48, paragrafi 1, nënpargrafi 5**, taksativisht thekson se: *"1 Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ*. Arsyetimi përmban*:* (1.5.) *"shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve"*. Pretendimet kryesore të STUDIO HAPSIRA SH.P.K fare nuk janë trajtuar nga AK. Andaj, bazuar në **nenin 48, par. 2** të po të njëjtit Ligj: "*Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij".* Prandaj një akt i tillë arbitrar dhe i kundërligjshëm duhet të ANULOHET nga OSHP.

Pretendimi 2: Vendimi për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim shpërfaq tejkalim të kompetencave të Komisionit të Vlerësimit

Në Vendimin për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, AK në mënyrë taksative thekson se: *"**Komisioni** i përbërë nga dy ekspert të fushës dhe një zyrtar i prokurimit publik, **ka konstatuar se në dosje të tenderit në paramasë janë përfshir pozicione të cilat nuk janë të nevojshme** dhe të cilat ndikojnë në implementim të projektit, pozicionet të cilat nuk janë të nevojshme: Pozicionin A pika 2,3,4, dhe 5, Pozicioni B pika 3, dhe 7 Pozicioni E, pozicioni F, Pozicioni G dhe Pozicioni H pika 2".*

STUDIO HAPSIRA SH.P.K vlerëson se NUK është PËRGJEGJËSI dhe as DETYRË e Komisionit të Vlerësimit të Tenderëve të vlerësoj se pozicionet e caktuara janë ose jo të nevojshme për AK-së. Kjo është përgjegjësi e Njësisë së Kërkesës, andaj Njësia e Kërkesës i identifikon nevojat dhe në bazë të nevojave i paraqet edhe pozicionet e caktuara.

Në nenin 10 të RrPP-së janë të saktësuara këto kompetenca dhe funksionet për Njësinë Kërkuese:

Neni 10

Funksionet e Njësisë së Kërkesës

10.1 Njësia e Kërkesës, e cila është iniciues e kërkesës për prokurim, për secilin aktivitet të prokurimit, ka përgjegjësitë në vijim:

a. Përgatitë një kërkesë të prokurimit, vlerësimin formal të nevojave sipas (DNPDF), dhe përcjellë këto të ZKA për aprovim;
b. Përgatit/propozon detyrën projektuese, projektin, specifikime teknike (ST), Termat e Referencës (TeR), dhe Paramasen dhe Parallogarinë;
c. Siguron që specifikimet teknike, projektet janë përgatitur në pajtim me Nenin 28 të LPP dhe Nenin 19 të kësaj rregullore.
d. Të bashkëpunojë dhe të asistoj departamentin e prokurimit gjatë procesit të prokurimit;
e. Nxjerr raporte për pranimin e mallrave/shërbimeve/punëve për aranzhimin e pagesës për Operatoret;
f. Raporton te departamenti i prokurimit çdo devijim nga kushtet e kontratës; dhe
g. Përcjellë në departament të prokurimit detaje të çdo kërkesë për amendamentim të nevojshëm të kontratës

Gjithashtu, bazuar në nenin **40, paragrafi 2** të **Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik** e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr.002/2024 (tutje RrPP) *"Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen* ***<u>në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit</u>*** *dhe kontrata do t'i jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve"*. Këtu kemi të bëjmë me tejkalim të kompetencave të Komisionit dhe kjo është në kundërshtim me nenin 40 të RrPP-së.

Andaj, Sipas nenit 40 të RrPP-së, Komisioni i Vlerësimit ka vetëm kompetencën për të vlerësuar tenderët në përputhje me kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Komisioni nuk ka asnjë kompetencë të ndërhyjë në pozicione të hartuara konformë kërkesave dhe nevojave të Njësisë Kërkuese. Komisioni i Vlerësimit nuk mund të rekomandojë anulimin e aktivitetit të prokurimit nëse ofertuesit i kanë përmbushur kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit. Ndërhyrjet e tilla në pozicione, jo vetëm që janë të paautorizuara, por edhe bien ndesh me parimin e ligjshmërisë dhe objektivitetit në procesin e prokurimit publik, kështu duke shkel rëndë posaçërisht nenin 1 dhe 7 të LPP-së.

Pretendimi 3: Aktiviteti i prokurimit është anuluar në kundërshtim me kërkesat ligjore

Fillimisht duhet theksuar se AK këtë aktivitet të prokurimit e ka anuluar pas hapjes së ofertave, konkretisht pasi ka kuptuar emrat e OE-ve ofertues dhe pasi ka kuptuar se "OE i preferuar i AK-së" ka dalë të jetë me çmim më të lartë se STUDIO HAPSIRA SH.P.K. Andaj e vetmja mënyrë për të na privuar nga e drejta për shpërblim me kontratë ka qenë anulimi i kundërligjshëm i këtij aktivitetit.

AK e ka anuluar aktivitetin e prokurimit pas hapjes së ofertave, konkretisht pas vlerësimit të ofertave sepse hapja e ofertave ka qenë më datë 23.05.2025, ndërsa Njoftimi mbi Vendimin e AK-së 16.06.2025, dhe atë me pretendimin se: ***"Në paramasën e publikuar nga AK-ja ka pozicione të cilat nuk janë të arsyeshme si në:***

- ***Pozicionin A pika 2,3,4, dhe 5,***
- ***Pozicioni B pika 3, dhe 7***
- ***Pozicioni E, pozicioni F,***
- ***Pozicioni G dhe***
- ***Pozicioni H pika 2.***

Bazuar në Nenin 62 të LPP-së një aktivitet i prokurimit mund të anulohet vetëm për këto arsye:

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

   1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

   2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

   2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Ndërsa sipas RrPP-së, procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet vetëm nëse ekzistojnë arsyet e mëposhtme:

43.5 Procedura e prokurimit *pas hapjes së ofertave* duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);
d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
g. asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose
k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

AK as në Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 16.06.2025 dhe as në Vendimin për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim, vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit nuk e bazon në dispozitat e nenit 62 të LPP-së, apo në dispozitat e 43.5 të RrPP-së.

Gjithashtu AK nuk ka dhënë ASNJË sqarim të vetëm mbi atë se pse Pozicionin A pika 2,3,4, dhe 5, Pozicioni B pika 3, dhe 7, Pozicioni E, pozicioni F, Pozicioni G dhe Pozicioni H pika 2 qenkan të panevojshme. Pra kush e vlerësoi këtë, si u bë që kjo të kuptohet **25 ditë pas hapjes së ofertave,** e kështu me radhë**.**

Po të ekzistonin arsye reale ashtu siç pretendon AK, kjo ka mundur lehtësisht të korrigjohet nëpërmjet procedurave ligjore, konkretisht nëpërmjet Formularëve Standard për korrigjimin e gabimeve. Mirëpo është më se e qartë se AK, pa ASNJË arsye faktike dhe ligjore dhe me qëllim të privimit të kundërligjshëm të kompanisë nga e drejta për shpërblim me kontratë, vendosë që të anuloj në tërësi aktivitetin e prokurimit.

Përtej kësaj, edhe po të ekzistonin arsyet reale për anulim, neglizhenca e AK-së për t'i adresuar me kohë lëshimet eventual nuk mund dhe nuk duhet të legjitimohet nga OSHP, kujtojmë se OE-të kanë bërë një mori shpenzimesh për të aplikuar, pastaj për të garantuar ofertën e tyre nëpërmjet sigurisë së tenderit. Andaj, këto janë shpenzime të konsiderueshme të cilat duhet ta pamundësojnë anulimin arbitrar dhe të pa bazuar në Ligj.

Gjithashtu për këtë aktivitet të prokurimit AK ka zhvilluar procedurë dhe me pretendimin që me OE-në fitues të nënshkruaj kontratë publike kornizë. Paramasa e AK-së lidhur me këtë aktivitet të prokurimit përbëhet nga gjithsej 33 pozicione, ndërsa AK e anulon aktivitetin në tërësi me pretendimin se kinse disa nga pozicionet nuk qenkan të nevojshëm. Përveç se nuk e ka justifikuar këtë vendim, në të njëjtën kohë koncepti i kontratës kornizë e pamundëson që AK të thirret në këto arsye. Kjo për faktin se AK në një kontratë kornizë do të paguaj vetëm për atë që porositë, dhe nëse një pozicion i caktuar është i panevojshëm, AK

thjeshtë nuk e porosit një pozicion të tillë. Pra kjo është edhe një arsye më shumë që anulimin praktikisht e bënë të pa justifikuar.

Përfundimisht kjo mënyrë e anulimit të aktivitetit të prokurimit është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe tejet arbitrare dhe si e tillë duhet të parandalohet nga OSHP si organ më i lartë vendimmarrës.

Andaj, mbi bazën e të sipër përmendurave, Organit Shqyrtues të Prokurimit, i propozojmë që të merr këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** tërësisht e bazuar Ankesa e parashtruar nga OE STUDIO HAPSIRA SH.P.K.

II. **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 16.06.2025, ashtu që **OBLIGOHET** Autoriteti Kontraktues KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, që lëndën ta kthej në **RIVLERËSIM** dhe pas rivlerësimit OE STUDIO HAPSIRA SH.P.K.të shpallet fituese si OE i përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

III. Meqë ankesa e OE STUDIO HAPSIRA SH.P.K. ishte e suksesshme, lejohet kthimi i tarifës së ankesës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ne si OE kemi pësuar dëme të konsiderueshme. Dëmet e pësuara (materiale dhe jo materiale) deri në këtë fazë të procedurës janë në vlerë 80,000 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*